

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës për konsultim për pagat: Presim vendimin e 'Kushtetuese s'
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/shoqata-e-gjyqtareve-refuzon-ftesen-e-rames-per-konsultim-per-pagat-p-i106385
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:03:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 07:55:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	946614f069a0c67789b427f5086c5686d6bc0291176486437cc8d671969bcf8f
TEKSTI	a4840be5625ff2f45b685aca6bfff3e2bf2621aa826aa9125a28c029b7b928488
PAMJA	d55e2e5c6fcbdbbb260d54fb07bec7a3c3f6fb19583152e47c9a16e9ab6376dd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	58ea4fcb831ff73e689c5b63df5a8be0cbb1fba78fcf20712a574eea5ed63dc2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/58ea4fcb831ff73e689c5b63df5a8be0cbb1fba78fcf20712a574eea5ed63dc2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISSIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

shpetimtare, fundit në
kërkohet vend pas
deveri arrestit të

Bushatit /
vite më parë
në

Shqipërinë
në një
"udhëkryq"

ne grepin e
'mashtimit
kompiuterik nga

një
porosie
nga

sekuestruan
telefonat

për
skandalin e
SHISH,

Kombetare
vetëm me
të

Begaj në
Pallatin e
Brigadave,
cilëson në

AKTUALITET

Shoqata e Gjyqtarëve refuzon ftesën e Ramës për konsultim për pagat: Presim vendimin e 'Kushtetueses'

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 09:55



Shoqata e Gjyqtarëve të Shqipërisë ka refuzuar ftesën e kryeministrit Rama për të marrë pjesë në tryezën e konsultimit të datës 28 shtator 2026, me objekt përcaktimin e pagave në sistemin e drejtësisë dhe përmirësimin e statusit të magistratëve.

Duke pasur parasysh se çështja objekt i konsultimit lidhet drejtpërdrejt me një proces kushtetues të iniciuar nga shoqatat e magistratëve pranë Gjykatës Kushtetuese, ata kanë kërkuar që një tryezë e tillë të zhvillohet pas një qëndrimi të Gjykatës Kushtetuese mbi çështjen. Sipas tyre pas një qëndrimi nga Gjykata Kushtetuese, dialogu institucional mund të zhvillohet mbi një kuadër më të qartë dhe duke respektuar plotësisht rolin dhe kompetencat kushtetuese të Gjykatës.

"Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë ju falënderon për përcjelljen e ftesës së Kryeministrit për zhvillimin e një takimi lidhur me çështjen e pagave të magistratëve dhe vlerëson gatishmërinë e shprehur për dialog institucional mbi një çështje që lidhet drejtpërdrejt me statusin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Shoqata ka vlerësuar në vijimësi se dialogu ndërinstitutional, kur zhvillohet në respekt të rolit dhe kompetencave kushtetuese të secilit pushtet, përbën një instrument të nevojshëm për identifikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Në këtë këndvështrim, çështja e trajtimit financiar të magistratëve nuk duhet parë e shkëputur nga tërësia e garancive që mundësojnë ushtrimin e pavarur, të përgjegjshëm dhe cilësor të funksionit gjyqësor.

Megjithatë, në rrethanat aktuale, kur çështje që lidhen drejtpërdrejt me standardin kushtetues të pagës së magistratëve janë bërë objekt i një procesi tashmë të iniciuar pranë Gjykatës Kushtetuese, Shoqata vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme pjesëmarrja e saj në një diskutim institucional mbi të njëjtën çështje përpara përfundimit të këtij procesi. Vendimarrja kushtetuese pritet të qartësojë parametrat brenda të cilëve mund të zhvillohet më tej një diskutim i plotë dhe konstruktiv për mekanizmin e trajtimit financiar të magistratëve.

Dër këtë arsye Shoqata eman se diskutimi i pranizuar mund të zhvillohet në një moment të mëvonshëm naci të jetë qartësuar kundri kushtetues nërkatës. Ku qëndrim nuk nërkën tërheqia nga

dialogu institucional dhe as kufizim të gatishmërisë sonë për të kontribuar në diskutime që synojnë përmirësimin e qëndrueshëm të funksionimit të sistemit gjyqësor.

Në vlerësimin tonë, një dialog i tillë nuk duhet të kufizohet vetëm në dimensionin financiar të statusit të magjistratit, por mund të përfshijë çdo element që ndikon në pavarësinë, eficientë dhe cilësinë e drejtësisë. Garancitë e statusit të gjyqtarit, përfshirë trajtimin financiar, nuk përbëjnë privilegje të një kategorie profesionale, por janë mjete institucionale që duhet të shërbejnë për krijimin e kushteve që gjyqësori t'u ofrojë qytetarëve një shërbim të pavarur, profesional, të paanshëm dhe efektiv.

Në këtë frymë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve mbetet e hapur dhe e gatshme për dialog e bashkëpunim institucional, në një moment të përshtatshëm dhe mbi një bazë kushtetuese të qartësuar, për çështjen e pagave të magjistratëve si dhe për çdo çështje tjetër që lidhet me forcimin e cilësisë dhe funksionimit të sistemit gjyqësor në interes të publikut”, thuhet në njoftim.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 28 Shtator09:34

[Një klikim, mijëra lekë: Si po bien shqiptarët në grepin e ‘mashttrimit kompjuterik’](#)

Gjithçka nisi nga një mesazh në telefon. Gentjana Driza ishte në pritje të një porosisë nga TEMU më 23 maj, kur mori njëe...

AKTUALITET 28 Shtator09:03

[Skandali i SHISH dhe shkarkimi i Vlora Hysenit, nis mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare](#)

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare e thirrur nga Bajram Begaj sapo ka nisur, ku në qendër të diskutimeve prite...

AKTUALITET 28 Shtator08:21

[Këmbimi valutor 28 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja](#)

Në tregun e këmbimit valutor shqiptar, një dollar amerikan do të blihet sot me 80.2 lekë dhe do shitet me 81.2 lekë. Ndërk...

AKTUALITET 28 Shtator08:03

[Arrestimi i Vlora Hysenit, sot do të mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare](#)

Bajram Begaj do të mblidh ditën e sotme Këshillin e Sigurisë Kombëtare, në orën 08:30, në Pallatin e Brigadave. K...

AKTUALITET 28 Shtator08:00

[14.783 ditë ferri: dokumenti sekret që tregonte çfarë ndodhte në burgjet e komunizmit pak para revoltës së Qafë-Barit](#)

Burgjet e komunizmit në Shqipëri nuk ishin thjesht vende vuajtjeje dënimi. Ato ishin makina frike, ku shteti përpiqej të shkatër...

AKTUALITET 28 Shtator07:52

[Zjarr në Gjirokastër/ Merr flakë makina, digjet edhe një kasolle](#)

Dy vatra zjarri kanë rënë mbrëmjen e kaluar në lagjen “Dunavat” në Gjirokastër. Një automjet ësh...

AKTUALITET 28 Shtator07:22

[Kthjellime dhe vranësira kalimtare, parashikimi i motit për sot](#)

Sot vendi ynë do të ndikohet nga kushte atmosferike relativisht të qëndrueshme. Moti parashikohet i kthjellët ndërsa përgja...

AKTUALITET 28 Shtator07:18

[Pasqyrë moj pasqyrë! Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta](#)

Çmimet nuk ulen me urdhër, me lista publike apo me portale që krahasojnë etiketat. Ulen kur ekonomia prodhon më shumë, kur buj...

AKTUALITET 28 Shtator07:13

[Rajoni dobët me menaxhimin e mbetjeve, mbi 83% përfundojnë në landfille](#)

Ballkani Perëndimor mbetet shumë larg Bashkimit Europian në menaxhimin e mbetjeve, pavarësisht investimeve të reja në landfille ...

AKTUALITET 28 Shtator07:08

[Turizmi “eco”, FSHZH lidh kontratën 2.4 milionë euro për glamping, tree houses e park aventure në Belsh](#)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) njoftoi së fundmi se ka lidhur kontratën për zgjerimin e Eco Park Dumrea në Belsh, projekti q&eu...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian ...](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Hakla...](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare t&...

INVESTIGIME 26 Shtator 13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.